




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Mifail Azizi (anëtar), Fatlum Demiri (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 18.05.2023, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ "Presingu" me Nr.12-320/04-18963, e datës 15.05.2023, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e OJQ "Presingu" me Nr.12-320/04-18963, e datës 15.05.2023, kundër Vendimi të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023.
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023.

## Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.05.2023 shqyrtoj ankesën e OJQ "Presingu" me Nr.12-320/04-18963, e datës 15.05.2023, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023, të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për paknaqësinë me përkrahjen që i është bërë në lidhje me shumën financiare të miratuar nga komisioni vlerësues, sepse e njëjta nuk i përmbush arritshmëritë e parapara të projektit tonë si klub, duke pretenduar se është i vetmi klub i gjinisë femrore në Komunën tone dhe kërkon që të shqyrtohet projekti.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstatoj se, ankesa e ankuesit OJQ "Presingu" është e pabazuar, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 17.05.2023 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ "Presingu". Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës së OJQ "Presingu" me Nr.12-320/04-18963, e datës 15.05.2023, konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- Komisioni vlerësues ka qenë i përbërë nga profesionistë të fushës dhe i njëjti ka respektuar neni 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikuesve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform nenit të cekur më lartë.

- Ne konsiderojmë që, komisioni për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësua e analizuar aplikacionin e OJQ “Presingu”, ka vendosur real, në përputhje me procedurat sipas Rregullores 04/2017 dhe është në diskrecionin e saj ndarja e shumës së mjeteve të ndara për OJQ “Presingu”.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kriteret e qarta, duke respektuar dyshkallëshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese;
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale;

Viti, më 18.05.2023

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Mifail Azizi, anëtar

Fatlum Demiri, anëtar

